



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Data	
Nr. Prot	

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR
SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. FREDI PANDI KOKONESHI, ISH KRYETAR I BASHKISË DIVJAKË
QARKU FIER

Referuar neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Në zbatim të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kryetari i Bashkisë”.

Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019, z. Fredi Pandi Kokoneshi, kandidat për Kryetar të Bashkisë Divjakë, Qarku Fier ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër 2660 unik datë 12.05.2019.

Në bazë të kompetencave të veta, KQZ bëri verifikimin “*prima facie*” dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 3107 prot, datë 13.05.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj me shkresën nr.1487/1, prot, datë 14.05.2019, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se kandidati për kryetar Bashkie, z. Fredi Pandi Kokoneshi, rezulton se nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në rrugë elektronike ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se kandidati për kryetar Bashkie, z. Fredi Pandi Kokoneshi, rezulton se nuk ka kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar bashkie z. Fredi Pandi Kokoneshi.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Fredi Pandi Kokoneshi, rezulton se i është përgjigjur me po vetëm pyetjes nr.8:

Pyetjes 8, “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

-Në vitin 1992 ka qëndruar për një periudhë dy mujore në Follorinë Greqi, për arsye pune.

-Në vitin 1993-1996 ka qëndruar në Magenta Itali, për arsye pune.

-Në Vitin 1997 ka qëndruar për një periudhë dy mujore në Romë, Itali.

Në përfundim të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.1097, datë 27.07.2029 miratoi “Shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019”, sipas të cilit z. Fredi Pandi Kokoneshi, u shpall fitues në funksionin e kryetarit të Bashkisë Divjakë, qarku Fier.

II

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr.93/1,Prot., datë 25.01.2018, pas ushtrimit të nismës nga 1/10 e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ka kërkuar verifikim të detajuar të të dhënave të deklaruara nga subjekti z. Fredi Pandi Kokoneshi, në zbatim të ligjit 138/2015.

Me shkresën nr. 188/10 prot., datë 15.07.2019, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Fredi Pandi Kokoneshi, Prokuroria e Përgjithshme pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatin e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Fredi Pandi Kokoneshi, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

Subjekti vetëdeklarues Fredi Pandi Kokoneshi, me detyrë, kryetar i Bashkisë Divjakë, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike me shkresën nr. 29 prot., datë 21.07.2022, ka paraqitur kërkesë drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, me objekt “Kërkesë për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit z. Fredi Pandi Kokoneshi.

Pranë Prokurorisë së Përgjithshme, më datë 22.07.2022, është paraqitur kërkesa nga subjekti politik “Partia Demokratike”, me objekt “Verifikimi i të dhënave të formularit të vetëdeklarimit të subjektit z. Fredi Pandi Kokoneshi. Me shkresën nr.1066/1 prot., datë 27.07.2022, Prokuroria e Përgjithshme i përcjell Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën e grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar indicjeve të bëra publike nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike si dhe përcjelljes së kërkesës nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme me shkresën nr. 3007 prot., datë 29.07.2022, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 1066/65 prot., datë 19 .07.2023, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin Z. Fredi Pandi Kokoneshi, Prokuroria e Përgjithshme pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Fredi Pandi Kokoneshi, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile të padeklaruara në formular apo të ndryshme nga ato të deklaruara;
- Nuk rezulton të jetë dënuar, për kryerjen e një vepre penale me vendim të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor;
- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Nuk rezulton të ketë qenë person nën hetim në ndonjë procedim penal, por rezulton të ketë qenë në gjykim me kërkesë të të dëmtuarit akuzues M.M për kryerjen e veprës penale të “Shpifjes”, parashikuar nga neni 120 i Kodit Penal në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë e cila me vendimin e formës së prerë nr. 284, datë 21.07.2016, ka vendosur të pushojë gjykimin e çështjes penale me nr. 309(415) akti, datë 08.06.2016;
- Nuk rezulton të ketë qenë i ndaluar apo arrestuar në flagrancë nga organet ligjzbatuese për kryerjen e ndonjë vepre penale;
- Nuk rezulton të jetë caktuar ndonjëherë ndaj tij masë shtrënguese e sigurisë personale;

- Nuk rezulton të jetë lëshuar ndonjëherë ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale;
- Nuk rezulton të jetë marrë ndonjëherë për të masa e dëbimit nga një shtet i huaj;
- Nuk rezulton të ketë të tjera indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion me qëllim verifikimi të mëtejshëm:
 - Për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - Për qënien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
 - Për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
 - Dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - Përdorimin e të dhënave personale/gjenealiteteve të tjera.

III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

Ligji nr. 138/2015 dhe vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar se subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjenealitetet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalime arrestime, hetime, etj).

Z. Fredi Pandi Kokoneshi, ish kryetar Bashkie në Bashkinë Divjakë Qarku Fier, si rezultat i zgjedhjeve të zhvilluara për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, nuk e ushtron këtë detyrë, dhe nuk është subjekt i këtij ligji. Komisioneri nuk mund të shprehet me vendimmarrje për çështjen objekt shqyrtimi, për sa kohë ky subjekt nuk gëzon statusin e Kryetarit të Bashkisë, dhe në asnjë rast e për asnjë rrethanë nuk do të mund të marrë këtë funksion publik për të cilin është iniciuar procedura administrative e verifikimit të thelluar. Komisioneri mund të shprehet vetëm kur përmbushen kushtet ligjore të moskandidimit, moszgjedhshmërisë apo mbarimit të mandatit për rastet e parashikuara në ligjin 138/2015. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të neneve 10 dhe 11 të ligjit 138/2015, si dhe neneve 90 dhe 95 të ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve.

Valbona BALLGJINI - Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Majlinda ÇELMETA - Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

Ylli MERKAJ - Sekretar i Përgjithshëm